



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 24 tetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Haki Demolli, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Amir Ahmeti, Mufera Šinik dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Arton Konushevc – Rel, Dejan Čosić – ICO, Lumnije Murati – ZPRK, Isuf Zejna – KDI, Sanije Berisha – OSBE, Lulzim Aliaj – MD dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26. 08. 2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70, me amendamentet e propozuara nga grupi i punës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-71 për Sistemin e adresave;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për shitjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta banesore, nr. 04/952/L-61,
8. Njoftimi i Komisionit me Vendimin e Kuvendit nr. 04-V-212, lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ndihmë juridike falas;
9. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që pika katër dhe pika shtatë të hiqet nga rendi ditës.

Rendi ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26. 08. 2011

Kryetari, konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26. 08. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70, me amendamentet e propozuara nga grupi i punës

U paraqiten për shqyrtim amendamentet e propozuara nga grupi i punës, mirëpo ishte konstatim i përgjithshëm që grupi i punës ta mbajë edhe një takim ku do të harmonizonte qëndrimet lidhur me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Komisioni paraqiti vërejtje në amendamentin 3.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Legjislacion kërkon nga Këshilli Konsultativ për Komunitete dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, që brenda një afati prej një jave, t'i përafrojnë qëndrimet e veta me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje të favorshme për të dy palët.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-71 për Sistemin e adresave

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Sistemin e adresave dhe nuk u paraqitën vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-71 për Sistemin e adresave, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Njoftimi i Komisionit me vendimin e Kuvendit nr. 04-V-212, lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ndihmë juridike falas

Kryetari, i njoftoi me vendimin e Kuvendit dhe me procesin se si ky Projektligj nuk është miratuar në seancë, me propozimin e kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa. Megjithatë ne e kemi lënë që në një mbledhje me Komisionin për Buxhet dhe Financa, në të cilin do të vijë edhe përfaqësuesi i Qeveris, që të shohim se cila do të jetë zgjidhja. Takimi do të jetë nesër në ora 11. Ky ishte veç sa për informimin tuaj.

7. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-52 për marrëveshjet ndërkombëtare

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare dhe nuk u paraqitën vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për marrëveshjet ndërkombëtare e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

b. Komisioni edhe një herë ngriti shqetësimin lidhur me mossjelljen e propozimeve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor nga radha e komuniteteve dhe u kërkua që propozimet t'i përcillen Komisionit sa më parë.

c. Armend Zemaj - Raportoi për punën e nënkomisionit rreth Rregullores së punës. Tha se ne e kemi finalizuar draftin javën e kaluar dhe ia kemi shpërndarë të gjitha komisioneve që t'i definojnë përgjegjësitë dhe detyrat për fushëveprimin e tyre. Jemi pajtuar që nuk ka diçka relevante që mund të ndryshojë atë. Po ashtu e njoftoi Komisionin se nënkomisioni do të realizojë vizitën në Turqi.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisioni

Arben Gashi